



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI.
Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 28.03.2018, në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Fikrim Damka, Fitore Pacollidhe Fatmire Kollçaku.

Munguan: Zenun Pajaziti, Adem Hoxha dhe Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

I ftuar: z. Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësuesi nga GIZ, OSBE, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

Rend dite:

- 1. Raportimi i z. Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, lidhur me procesin e liberalizimit të vizave.**

Kryetarja, fillimisht falënderoi anëtarët e komisionit, që u pajtuan për zhvendosje të agjendës, pasi që mbledhja ishte planifikuar të mbahet në orën 11:00, por për shkak të agjendës së ministrit, ne po e mbajmë takimin tani.

Në vazhdim, i uroi mirëseardhje ministrit dhe tha se iu kemi ftuar bashkë me ministren e Integritetit Evropian, znj. Dhurata Hoxha, që të raportoni lidhur me kriterin e mbetur për liberalizimin e vizave, sepse pas ratifikimit të demarkacionit, institucionet tona duhet të vazhdojnë përkushtimin e tyre institucional për luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Pra, dëshirojmë që të na njoftoni se sa po përmbushet ky kriter, sepse e dimë që është kërkuar ndërmarrja e masave legjislative, është një pako e reformave që prek sundimin e ligjit, që garanton progres. Lidhur me kriterin e mbetur, çfarë ka ndërmarrë konkretisht ministria që ju e drejtoni, për të intensifikuar punën në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit?

Ministri i Drejtësisë, z.Abelard Tahiri, mori fjalën dhe paraprakisht falënderoi komisionin për mirëkuptimin për vonesën për mbajtjen e takimit. Në vazhdim, tha se në kuadër të angazhimit, si ministër i Drejtësisë, janë dy komponentë tejet të rëndësishëm, që ndërlidhen në përmbushjen e këtij kriteri mjaft të rëndësishëm, pra fuqizimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe po ashtu avancimi i legjislacionit në këtë fushë.

Ekziston një mekanizëm përcjellës, ku janë shenjzuar 39 raste, mbi të cilat iu ka informuar edhe ministrja e Integritimit Evropian, por më tepër do të fokusohem te mandati im si ministër i Drejtësisë. Masat e ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë, në aspektin e politikë bërjes, që ndikojnë në fuqizimin e sundimit të ligjit, rrjedhimisht në luftën e krimit të organizuar dhe korrupsionit, po ashtu janë të adresuar indikatorë të mirëfilltë për liberalizimin e vizave nga 3 perspektiva:

1. Janë adresimet nga rekomandimet nga raporti i vendit për vitin 2016. 2. Përmbushja e obligimeve që dalin nga MSA. 3. Adresimi ynë, konform agjendës së BE-së, që e kishim tash strategjinë për zgjerim. Sa i përket përmbushjes së obligimeve tona, si Qeveri dhe ministri, në aspektin legjislativ, tashmë vetëm kemi proceduar pakon prej 4 ligjeve në Kuvend.

2. Çështja e tjetër, që ndërlidhet me angazhimet e Qeverisë, është rritja e buxhetit për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, dhe në kuadër të vitit 2018, institucionet e sektorit të sundimit të ligjit do t'i kenë 690 vende të reja shtesë.

3. Si rekomandim nga raporti për vendin për vitin 2016, është hartimi i Kodit Civil të Kosovës, që do të mundësojë edhe unifikimin e të drejtave pronësore. Janë themeluar grupet punuese dhe është hartuar drafti i parë, dhe me ndihmën e një projekti të BE-së, kemi intensifikuar punën dhe besoj që deri në fund të nëntorit, do ta kemi draftin final, të cilin do ta kemi në Qeveri, për miratim.

Çështje tjetër, mjaft e rëndësishme në angazhimin tonë në fuqizimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, është rishikimi i Kodit penal dhe rishikimi i Kodit të procedurës penale.

Amendamenti i Kodit penal ka prodhuar një kod të ri penal, janë inkorporuar 19 nene, që lidhen në adresimin e çështjes, që ndërlidhen në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Çështje tjetër, që është diskutuar shumë, është edhe parashkrimi i lëndëve, për shkak të mos-efikasitetit dhe mosarritjes së gjyqësorit që t'i përmbushë. Ne e kemi parë të arsyeshme që për një numër të veprave penale që ndërlidhen me keqpërdorimin e parasë publike, do të rritet viti i parashkrimit të veprave penale, që do t'i mundësojë gjyqësorit të arrijnë ta përmbushin mandatin e tyre. Po ashtu, edhe rritjen e dënimeve për veprat që ndërlidhen me vepra korruptive dhe të keqpërdorimit të parasë publike.

Një çështje tjetër, që ndërlidhet me Kodin penal, është që në momentin kur një zyrtar publik do të dënohet për aferë korruptive, ai së paku 10 vjet nuk do të mund ta ushtrojë veprimtarinë e vet në institucionet publike. Pjesa tjetër që adresohet nga agjenda evropiane, është edhe rishikimi i Ligjit për mbrojtjen e informatorëve. Tani është formuar një grup punues dhe deri në fund të prillit do ta përcjellim ligjin në Qeveri. Kosova e ka Ligjin për informatorët, por deri më tani ka qenë joefikas. Rekomandim tjetër i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, është edhe rishikimi i politikës së sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë dhe kjo mbetet një ndër çështjet me prioritet të Ministrisë së Drejtësisë.

Sa i përket mekanizmit përcjellës të rasteve që ndërlidhen me liberalizimin e vizave, është një proces mjaft i rëndësishëm. Lidhur me këtë, i kam mbledhur të gjithë aktorët e

sundimit të ligjit, gjithnjë duke mos i ngatërruar kompetencat dhe duke mos u involvuar në punën dhe politikat e ndëshkueshmërisë së institucioneve.

Është një avancim në këta 4 muajt e fundit dhe e kemi edhe një konfirmim nga BE, se ka pasur një avancim, sa i përket çështjeve të 39 rasteve që janë. Ne jemi të përkushtuar dhe rikonfirmoj qëndrimin tonë në përmbushjen e obligimeve tona, që ky kriter të përmbushet dhe në fund të këtij viti, qytetarët tanë të lëvizin lirshëm, pa viza.

Kryetarja, i tha ministrit se do të ishte në dobi të komisionit, që të kemi secilin raport që ju e posedoni, për të arriturat që i ka, veçanërisht Ministria e Drejtësisë, në luftimin e krimit dhe korrupsionit, sepse kjo do të na ndihmonte t'i shtyjme agjendat tona, jo vetëm sa i përket liberalizimit, por edhe agjendës evropiane të Kosovës.

Armend Zemaj, tha se sot po flasim prej një prizmi të bashkërendimit të aktiviteteve. Interesimi është për pjesën që përmbushet për liberalizimin e vizave. E keni përmendur edhe në fillim, edhe tash se kjo po përcillet për ndryshimin e një mori ligjesh, që unë e kuptoj që e keni marrë si pengesë në luftimin e krimit dhe korrupsionit në vend. Ajo që kërkohet, përpos vullnetit, është edhe llogaridhënia që u përmend edhe nga ministria e Integritetit Evropian, sepse kemi të bëjmë me një kërkesë, me disa lëndë, të cilat janë në procedurë, për të cilat politika nuk do të duhej të përzihej, por duhet të kërkohet llogaridhënie në përmbushjen e tyre dhe adresimit të krimit dhe korrupsionit në vend. Atë që po shohim ne dhe qytetarët, ka ngecje dhe nuk ka rezultate.

Pyetja është, ju si Ministri e Drejtësisë, a keni marrë ndonjë shqetësim zyrtar nga ndonjë prokuror apo gjyqtar për kërcënim, shantazh, për ndonjë rast të caktuar? Nëse po, atëherë duhet ta adresojmë mbrojtjen ligjore, nëse jo, atëherë është një konkludim shumë serioz në luftimin e këtyre rasteve, që janë të profilit të lartë. Rastet që procedohen nga EULEX-i, gjyqtarët dhe prokurorët tanë hezitojnë t'i marrin rastet e profilit të lartë, sepse janë të ndërlidhur me politikën. Pse po e bëjnë këtë? Ju duhet të keni informatë nga Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor dhe Kuvendi ta thotë fjalën e vet dhe të kërkohet edhe përgjegjësi, pavarësisht pjesës legjislative.

Unë besoj se kjo do të jetë bazë e ndryshimit, sepse nëse këtë nuk e ndryshojmë, atëherë ne do të sillemi në rreth vicioz dhe do të atakohemi edhe personalisht, edhe politikisht dhe Kosova e qytetarët nuk do të përfitojnë dhe do të kemi asi lloji të raporteve që u lexuan nga ekspertët dhe mekanizmat ndërkombëtarë. Besoj që, si ministër, këtë e keni parasysh dhe nuk duhet të mbetet vetëm retorikë, por shqetësim i përbashkët që këto çështje të marrin prioritet, por shqetësuese për mua është se numri prej 39 rasteve, që është duke u përmendur që 3 vjet dhe as nuk po rritet, ndërsa rastet e vendimit të prerë po mbesin në 7.

Tani nuk po e di se a po hyjnë të reja apo janë vetëm këto raste të profilit të lartë dhe këtu, ne duhet të jemi të kënaqur dhe të presim ndryshimet legjislative, por ndryshimet legjislative nuk janë pengesë e luftimit të krimit dhe korrupsionit në vend, pengesë janë burokratët dhe njerëzit që nuk kanë vullnet t'i shtyjnë këto raste. Këtu duhet angazhim konkret, sepse nuk është vetëm pjesa e ndryshimit legjislativ, por duhet ta gjeni mënyrën dhe besoj se e keni bërë, se çka po doni të ndryshoni, sepse po prekni bukur në sistem dhe ata njerëz duhet të njoftohen me atë sistem dhe t'u jepet kohë, sidomos rasteve të ndjeshme që barten prej EULEX-it, qoftë ato për luftimin e krimit dhe korrupsionit apo njolla më e zezë, siç janë rastet e vrasjeve politike në Republikën e Kosovës, sepse edhe ato do të adresohen si pjesë e krimit të organizuar, pavarësisht motivit politik që do të adresohet në vazhdimësi.

Ministri, tha se sa i përket ndryshimeve që jemi duke i ndërmarrë, është e vërtetë që do të thotë i prekim ligjet bazike, mbi të cilat punon gjyqësori dhe prokuroria, siç është Kodi penal dhe Kodi i procedurës penale dhe ju informoj se këto janë rekomandime që kanë dalë nga raporti për vendin, i Komisionit Evropian vitit 2016, kurse sa i përket plotësim-ndryshimeve që kanë filluar, para se të vij unë, si ministër, të gjitha janë bërë në harmoni të plotë dhe në koordinim me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, Komisionin Evropian dhe disa ekspertë që i kemi të angazhuar nga Ambasada e SHBA-së dhe në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së.

Ne kemi stagnuar në këtë proces, si vend, sepse nuk kemi ecur me ritmin e duhur, për të plotësuar këtë agjendë, për shkak se ishin zgjedhjet në vitin 2017.

Sa i përket kërcënimeve dhe shantazheve,ta them me përgjegjësi të plotë se askush, asnjëherë nuk ka marrë asnjë shkresë anonime dhe as shkresë të hapur për kurrfarë kërcënimi dhe shantazhi. Tani, jemi në proces të transferimit të lëndëve, nga EULEX te vendorët. Po ashtu, kemi pasur rastet sensitive, për të cilat nuk kanë pasur hezitim prokurorët dhe gjyqtarët, të merren me këto çështje. Ne do të flasim në një mbledhje tjetër për efikasitetin e punës së EULEX-it, gjatë këtyre dy viteve të fundit.

Jam i interesuar që të rritet numri i zyrtarëve profesionalë, mbështetësve ligjorë, që të jenë ndihmë e këtij procesi, sepse është një proces që mban qindra mijëra euro të qytetarëve, kreditorëve dhe bizneseve të ndryshme, që janë nëpër gjykata dhe mbesin të pazgjidhura.

Fitore Pacolli, tha se në mbledhjen e fundit të komisionit, u dakordua që të kërkojmë prej ministrave raporte të mira, të cilat pasqyrojnë në detaje ngecjet, përparësitë dhe avancimet, mirëpo ne jemi duke degraduar si komision, në këtë drejtim.

Është interesant se ministrja e Integritetit Evropian, gjatë prezantimit të saj, tha se është përmbushur kriteri kryesor për luftimin e krimit dhe korrupsionit, kurse ju gjatë prezantimit tuaj ministër, theksuat se ky kriter duhet të përmbushet. Pyetja ime është, a është përmbushur ky kriter apo duhet të përmbushet?Sepse, qytetarët janë manipuluar dhe tash po del se jemi në proces të përmbushjes, por po e shoh se jemi shumë larg.

Në bazë të kërkesave që ka dërguar edhe Komisioni Evropian, kërkohet të krijoni një regjistër të hetimeve, të vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe regjistër të konfiskimeve dhe a mjaftojnë 7 vendime të formës së prerë,për të marrë liberalizimin e vizave?

Lëvizja Vetëvendosje ka pasur një konferencë, ku ka prezantuar raportin e 3 ekspertëve evropianë, i cili është mbajtur i fshehur nga ministria juaj dhe Ministria e Integritetit Evropian dhe deri më sot nuk keni mohuar as pohuar se keni marrë një raport të tillë.

Gjatë prezantimit tuaj, nuk prezantuat asnjë dështim, por vetëm anën pozitive të disa veprimeve që i keni ndërmarrë, ndërsa raporti konstaton se ka shumë probleme, dhe nëse hyjmë në detaje, atëherë dikush duhet të japë përgjegjësi.

Ministri, ndërhyri dhe tha se ky raport nuk përfaqëson qëndrimin e Komisionit Evropian, mos manipuloni,sepse raporti është bërë për sistemin e gjyqësorit në Kosovë.

Fitore Pacolli, tha se ky raport është bërë nga ekspertët evropianë të vendeve anëtare dhe raporti ka konstatuar se sistemi i drejtësisë në Kosovë ka dështuar në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sidomos të nivelit të lartë dhe thekson se ka mungesë të theksuar të harmonizimit të ligjeve me BE-në dhe ka pavarësi të gjyqësorit, si dhe është e cenuar autonomia e prokurorëve në hetimin e rasteve në nivelin e lartë dhe këtu jemi duke ngecur.

Gjyqësori mbetet joprofesional dhe joefikas dhe i ndikuar politikisht dhe prokurorëve specialë iu mungojnë aftësitë dhe eksperiencia, që të merren me rastet komplekse të krimit dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Nuk ka përqendrim në rritjen e efikasitetit të instrumenteve ligjore për zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të përfituara në mënyrë të jashtëligjshme, si dhe shumë vërejtje tjera, ka konstatuar ky raport. Pyetja e fundit, ministër, a pajtoheni me të gjeturat e këtij raporti?

Ministri, theksoi se ky raport është hartuar prej 3 ekspertëve: nga një gjyqtar, një prokuror dhe një kryeinspektor. Këta 3 ekspertë kanë qëndruar në Kosovë për 3 ditë dhe kanë arritur të ky vlerësim dhe nuk e mohoj se ka të meta dhe kemi shumë probleme në sistemin e drejtësisë, mirëpo shumë prej këtyre çështjeve, që para se të vijjnë në përfundim këta ekspertë, ne i kemi adresuar dhe në Ligjin për prokurorin e shtetit, i kemi zvogëluar kriteret dhe si rekomandim i Komisionit Evropian, në mënyrë që t'i barazojmë kriteret me prokurorë të krimeve të rënda në Prokurorinë Themelore, që ta risim efikasitetin me numrin e prokurorëve në Prokurorin Speciale. Mund të them se Republika e Kosovës e ka numrin më të vogël të gjyqtarëve në Evropë për kokë banori dhe ne nuk mund të presim mrekulli nga ata njerëz, por e rrisim numrin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, për aq sa është e nevojshme. Pa dyshim, ka shumë të meta tjera që janë adresuar në këtë raport, por për mua është më i rëndësishëm raporti i vitit 2016, që adreson të gjitha problemet, e jo problemet e një raporti të përpiluar për 3 ditë qëndrimi në Kosovë.

Po ashtu, për mua është e rëndësishme Strategjia për zgjerim, dhe konform saj, kemi filluar rishikimin funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Ne nuk presim menjëherë mrekulli, por me rritjen e buxhetit dhe përmirësimin e politikave legjislativë, besoj se gjendja e gjyqësorit, në një të ardhme të afërt, do të përmirësohet ndjeshëm. Te çështja e 39 rasteve, nuk kemi të bëjmë me rastet e njëjta prej fillimit. Në muajin e fundit i kemi edhe 2 raste të reja, që kanë hyrë dhe ky është një proces që në vazhdimësi jep rezultat dhe institucionet tona kanë rezultat, në këtë drejtim.

Nuk kam dyshim në vullnetin dhe gatishmërinë e institucioneve tona, për ta përmbushur këtë kriter, sepse në vazhdimësi, për këtë kriter, ne përcillemi nga BE.

Projektligji për Këshillin Prokurorial dhe Projektligji për Këshillin Gjyqësor, që u përmendën, kanë qenë në të kaluarën, sepse kanë qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ne tani po arrijmë t'i përmbushim nevojat dhe të gjitha këto ndryshime që po i bëjmë, vijne si rezultat i ndryshimeve nga këto 3 perspektiva e që janë: MSA, raporti për vendin dhe Strategjia për zgjerim, dhe këtë të fundit, e adresojmë me rishikimin funksional të sistemit të drejtësisë.

Është reforma më e madhe që ka ndodhur në sektorin e sundimit të ligjit dhe besojmë se do të kulmojë me një strategji se do ta japë një drejtim sesi do t'i qasemi më tutje këtyre çështjeve.

Ju siguroj se këtë reformë që e kam nisur me plotësim-ndryshim të 18 ligjeve, do të jetë e suksesshme dhe do të ndikojë në pavarësimin e mëtutjeshëm të prokurorisë dhe gjyqësorit.

Unë nuk mund të ndërhyjë në punët e tyre, sepse janë të pavarur, por e kam një të drejtë morale të komunikimit me ta, që çdo pengues të kësaj agjende, ta nxjerrim para drejtësisë.

Fitore Pacolli, pyeti ministrin: A mendoni që është plotësuar kriteri për luftimin e krimit dhe korrupsionit, po ose jo, dhe tregoni se a pajtoheni me të gjeturat e raportit dhe pse në reagimin tuaj, pas konferencës, nuk thoni se keni raport, por e mohoni?

Ministri, tha se në disa çështje që janë ngritur në këtë raport i kemi adresuar mospajtimet tona. Në fillim të raportit, thuhet se ky raport nuk pasqyron qëndrim të Komisionit Evropian, por vetëm të këtyre 3 ekspertëve dhe do t'ua dërgoj me shkrim të gjitha mospajtimet tona, të adresuara në lidhje me këtë raport, sepse për shumë çështje nuk jemi pajtuar.

Në këto momente, me këtë normë që e kemi, e kemi plotësuar kriterin, por ne do të vazhdojmë dhe nëse pas dy muajve kemi ngecje, atëherë do të paraqitet si ngecje, sepse ky është një proces.

Fitore Pacolli, pyeti prapë ministrin: Pse nuk e pranuat raportin pas konferencës?

Ministri, theksoi se unë nuk kam folur për raport dhe nuk e kam pranuar, sepse nuk jam pajtuar me shumë të gjetura aty.

Illir Deda, e vlerësoi si jo korrekte të lexojë një material, të cilin nuk e kanë marrë të gjithë deputetët. Ai tha se ne këtu e kemi ftuar ministrin të raportojë për pjesën e punës së tij, që i përket përmbushjes së kriterit të liberalizimit të vizave dhe nuk ka asnjë pikë tjetër në rend dite. Në vazhdim, pyeti ministrin: Çka duhet të bëni për ta hequr ndikimin politik në gjyqësi dhe prokurori? Më tej, theksoi se nuk është çështje ligjesh, sepse i kemi shumë të mira, por është politika që nuk lejon punën e mirë të këtyre institucioneve. Tani, kur kanë ardhur ekspertët e huaj, gjyqtarët dhe prokurorët tanë iu thonë atyre se kanë ndikim politik. Është e vërtetë që kanë dhe nuk mund të mbetet një shtet me atë se kush kujt çka i tha, do te thotë se ata njerëz duhet të kryejnë punën me përgjegjësinë që e kanë, nëse janë të paafte që të ndjekin krimin dhe korrupsionin në nivel të lartë, le të dalin dhe të tregojnë, pse nuk janë duke e bërë.

Më herët ishte ministrja e Integritimit Evropian, e cila na tha se nuk ka pako të re ligjore. Neve na u ka komunikuar prej kanaleve tona, se lufta kundër krimit dhe korrupsionit për liberalizimin e vizave, përbëhet prej 3 shtyllave dhe unë dua t'iu pyes, cilat janë këto 3 shtylla, çka përmbajnë? Dhe, mundësisht, na i dërgoni edhe me shkrim, pastaj.

Ministri, tha se nuk jam në dijeni për 3 shtylla, por janë dy komponentë të rëndësishëm në përmbushjen e këtij kriteri, është politikë bërja, që jam përgjegjës unë, si ministër dhe komponenti i zbatimit të ligjit, që janë përgjegjës zbatuesit e ligjit.

Ekziston pakoja e ligjve, që ndërlidhet në raportin e vendit për vitin 2016 dhe që lidhet me liberalizim të vizave, është Kodi penal, tek i cili janë bërë ndryshime rrënjësore.

Ajo që duhet të kryhet, është të miratohen Ligji për prokurorin e shtetit dhe Ligji për parandalimin e konflikt interesit, që janë në Kuvend për lexim të dytë dhe që ndërlidhen edhe me raportin për vendin, që publikohet më dt.17 prill dhe agjendën tonë për përmbushjen e këtij procesi e kemi gjatë këtij viti.

Ajo që është më e rëndësishmja për liberalizim të vizave, është mekanizmi përcjellës, dhe aty, ne duhet të tregojmë rezultat të vazhdueshëm, derisa të ndodhë liberalizimi i vizave.

Fatmire Kollçaku, tha se ne e kishim paradite një takim me ministren e Integritimit Evropian dhe tani me juve dhe po bini në kundërthënie njëri me tjetrin, sa i përket përmbushjes së kriterit kyç, i cili është krimi i organizuar institucional dhe korrupsioni, një problem që shoqëria është ballafaquar gjithë këto vite. Tani po del se qenka lehtë të përmbushet, falë liberalizimit, kinse me një shkop magjik, brenda natës, këtë kriter do ta përmbushim. Tani, ne veç e kemi paguar çmimin, me ratifikimin e demarkacionit, i

cili është promovuar në publik, si kusht kyç e vendimtar, dhe menjëherë pas përmbushjes së tij, doli që nuk kemi datë për liberalizim, siç e ka thënë znj. Apostolova. Raporti i hartuar prej 3 ekspertëve, që ju po e minimizoni dhe po thoni se është raport më tepër privat, është një raport shumë më ndryshe dhe do t'i referohen të gjithë, sepse aty ka gjetje alarmuese dhe nuk mund të jenë dy realitete, që një raport të konstatojë defekte të mëdha në luftën e krimit dhe korrupsionit.

Duhet ta dimë sa është kredibil dhe sa i referoheni, sa është i besueshëm, sepse nuk është bërë prej njerëzve privatë, por prej një misioni që ka konstatuar shumë shkelje. Dhe nëse i referohemi këtij raporti, është e pamundur që deri në fund të këtij viti ta fitojmë liberalizimin, sepse nuk ka dallime pozitive apo opozitive, sa i përket kësaj çështjeje. Të gjithë kemi dëshirë të kemi një lëvizje të lirë të qytetarëve e jo ikje të lirë të qytetarëve, të cilët një situatë të pashpresë në vend do ta presin liberalizimin, kur e dimë se 70% është popullatë e re dhe ata presin veç të hapen dyert dhe të ikin nga vendi. Ky nuk është interes i Kosovës, por interesi është që të krijohet klimë e perspektivës, por nuk mund të krijohet, derisa nuk luftohet krimi dhe korrupsioni, që janë prezentë në çdo institucion.

Deri më tani nuk po shohim se po i qasemi seriozisht këtij problemi, sepse nuk kemi pasur raste që janë dënuar zyrtarë të nivelit të lartë. Po ashtu, prolongohen rastet dhe nuk zgjidhet asgjë, përveç te rastet e nivelit të ulët. Në fund, kërkoj nga ministri një qëndrim konkret lidhur me këtë raport. A bazoheni në të dhe cila është qasja juaj për t'i adresuar gjetjet shumë serioze? Na i dërgoni mospajtimet që ju i keni dërguar, që pastaj ta kemi një debat tjetër, sepse ne e dimë se zyrtarët e përfshirë në këto vepra, vijnë nga subjektet që janë në pushtet dhe është vështirë që ata të tregojnë vullnet, që të luftojnë brenda vetes dhe kjo është sfida më e madhe që na pret neve.

Ministri, i lexoi emrat e tre ekspertëve dhe tha se në raport thuhet se ky raport paraqet pikëpamjet e shprehura, pra janë vetëm të autorëve dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se mund të shprehin qëndrimin zyrtar të Komisionit Evropian. Prej shumë të gjeturave të këtij raporti, ne nuk pajtohemi, i kemi adresuar dhe iu kam shkruar tre autorëve. Po ashtu, këtë raport dhe mospajtimet tona do t'ua dërgoj edhe juve në komision.

Fatmire Kollçaku, tha se faktin sesi po e paraqitni ju, po del se ata kanë ardhur vetëm për ndonjë punim të doktoratës dhe ju thatë se iu keni shkruar për mospajtimet, a keni marrë ndonjë përgjigje prej tyre, sepse mos dalja në publik me këtë raport dhe mos transparenca, edhe nëse do të kishit të drejtë, krijon paqartësi në publik.

Kryetarja, ndërhyri dhe tha se pajtohem me z. Deda, kur tha se nuk është korrekte të diskutohet për një raport që nuk e kanë deputetët.

Ministri përsëriti edhe një herë se në këtë raport shkruan qartë se nuk paraqet qëndrimin zyrtar të Komisionit Evropian.

Milaim Zeka, tha se ne ju kemi ftuar, ministër që ju të jepni shpjegime konkrete, se çka duhet të bëjmë ne si deputetë, për t'i kaluar ligjet dhe për t'i plotësuar kriteret për liberalizimin e vizave, e jo të shahemi mes veti, sepse këtë mundësi e kemi në seancë. Në vazhdim, tha se edhe më herët, unë kam kërkuar që, duke u bazuar në përvojat e disa parlamenteve perëndimore, takimet me ministra të mbahen me dyer të mbyllura, pa prezencën e gazetarëve, sepse këto nuk janë konferenca shtypi.

Sa i përket këtyre raporteve, ne kemi raporte shumë të zeza, që i ka marrë bota prej vetë deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe ka raporte ku 96% e deputetëve, në seanca fare nuk flasin për temat e rendit të ditës. Ekspertët që bëjnë raporte të tilla janë raporte interne, po flas për diçka, pa u referuar në raporte, gjendja në sistemin e drejtësisë është katastrofale dhe këtë e di çdo qytetar i Kosovës, e lëre ne si deputetë, por krejt këto faje i ka UNMIK-u dhe EULEX-i dhe institucionet zyrtare të Qeverisë së Kosovës. Përgjegjësia kryesore për sundimin e ligjit, për policinë dhe sistemin e drejtësisë ka qenë kompetencë ekskluzive EULEX-it, sepse asnjë gjykatës, prokuror dhe asnjë shef i policisë nuk ka mundur të emërohet dhe nuk mund të emërohet, pa e marrë vizën prej BE-së-EULEX-it. Pra, do të thotë, kur të hiqet kjo, atëherë, ministër, ju e keni kompetencën ekskluzive për t'i vendosur në këto pozita të larta.

Në fund, pyeti për Kodin penal, që është duke e hartuar, a do të keni guximin qytetar, njerëzor dhe si jurist, ta riktheni atë nenin e famshëm, para të cilit u step ish-ministri, që shpifja të konsiderohet veprë penale dhe gazetarët, në çfarëdo situatë, burimin e informacionit duhet ta tregojnë para gjykatës, sepse nuk mund të lejohet që të vijë deri te shkatërrimi i jetës personale të një deputeti, ministri, artisti e të tjerëve, duke u thirrur në qarqe të ndryshme të portaleve të mediave, në burime të informacionit, se gjoja janë burime anonime dhe nuk tregohet burimi i informacionit. Për mua, kjo është me rëndësi, kurse për të tjerat, kemi mundësi që në seancë me u sha bashkë.

Armend Zemaj, theksoi se domosdo raporti i ekspertëve u bë pjesë e diskutimit, por mendoj se nuk duhet edhe ta humbë seriozitetin, sepse siç kuptova nga ministri, që tha se ky raport nuk paraqet qëndrimin e BE-së, por nëse ky nuk është qëndrim dhe dikush iu ka kërkuar këtë raport dhe ndërtojnë qëndrim, atëherë edhe ne duhet të jemi vigjilentë sesi e adresojmë.

Ministri, theksoi se nuk është se nuk e kemi marrë me shqetësim këtë raport dhe për atë arsye i kemi adresuar të gjitha mospajtimet tona, që ne mendojmë se nuk janë korrekte në këtë raport, masat që i kemi ndërmarrë në këtë raport dhe kur ia dërgojnë pastaj këta raportin nuk e di.

Kurse, sa i përket pyetjes së deputetit Zeka, Kodi penal ka përfunduar dhe nuk është përfshirë neni që ju e përmendet dhe nuk e besoj se edhe me amendament në Kuvend mund të përfshihet, sepse ajo çështje është kritikuar edhe nga Komisioni Evropian dhe besoj që në momentin që do ta kthejmë, do të jetë regres për Republikën e Kosovës.

Ahmet Isufi, theksoi se ne, si deputetë dhe si komision parlamentar, duhet të bazohemi vetëm në raportin zyrtar tuajin dhe raportet zyrtare, sepse ato janë serioze dhe kredibile, por edhe raportet tjera duhet t'i përfillim, sepse ka edhe raporte të pavarura, që me hulumtimet e tyre, e ndihmojnë ndoshta edhe njoftimin dhe informimin lidhur me zhvillimet në përgjithësi, në dikasterin tuaj.

Por, për mua, më e rëndësishmja është që ta ndryshoni mënyrën e veprimit në të gjitha segmentet e drejtësisë, pa u ndërhyrë politikisht, duke i avancuar si funksionim i sistemit të drejtësisë dhe politika e ministrisë duhet të bazohet në këtë drejtim dhe ta bëjnë më të avancuar sistemin e drejtësisë në Kosovë. Meqë është kriteri i fundit që ka mbetur, atëherë energjia juaj dhe të gjithë ata që janë të angazhuar në drejtësi, duhet të jenë më të fokusuar, sepse po përmendet edhe një afat deri në fund të vitit dhe ne mos të dalim ndryshe, sepse humb edhe kredibiliteti i institucioneve të Kosovës, por na mundësoni që edhe ne si pozitë dhe si opozitë, të kemi një opinion si Kosovë, para BE-së, në raport me liberalizimin e vizave që po e presin qytetarët.

Ministri, për fund, tha se ju mbeta borxh t'ju informoj se sa i përket proceseve gjyqësore dhe stërzgjatje së tyre, ne jemi në plotësim-ndryshim të Kodit të procedurës penale dhe brenda dy muajve do të përfundojë, sepse ky kod i adreson të gjitha këto çështje dhe konsideroj se reforma legjislativë dhe ngritja e kapaciteteve në këto dy këshilla, do ta rrisin efikasitetin e sundimit të ligjit.

Kryetarja falënderoi ministrin dhe kërkoi që t'iu dërgohet raporti të gjithë anëtarëve të komisionit, edhe pse tha se ky raport nuk paraqet qëndrimin e Komisionit Evropian, por është raport i ekspertëve dhe pajtohem me atë që u tha se jo rrallë ato raporte janë bërë pjesë e raporteve për vendin dhe kanë hyrë si sfida dhe ne si deputetë të jemi të informuar edhe për ato raporte që nuk janë raporte zyrtare të Komisionit Evropian.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu- Kodra
